




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-18-6764-5-2-1/C218
14 Nr. 1105/19
Dt. 24.10.2019

KONTRATË PUNE

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson : **Saranda Cakaj – Drejtoreshë për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme PORORSITËSI)** , dhe
2. “ **Deshishku GB “sh.p.k.** me seli në Prishtinë, me ARBK : **810007460**, të cilën e përfaqëson **z. Gentian Deshishku**, në tekstin e mëtejme: **RYESI I PUNËVE**,

, janë pajtuar të lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

Ndërtimi i kanalizimit fekal Stanofc – Breznicë , me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	67	6	4	5	2	1
Prokurimi Nr.	644	1	9	1	0	8	5	2	1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit, si vijon : **Ndërtimi i kanalizimit fekal Stanofc – Breznicë**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me nr. Referues : **644-19-108-521**.
- 1.2 **Afati i fillimit të punimeve është 2 (dy) ditë pas nënshkrimit të kontratës**, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.
- 1.3 Projekti do të realizohet brenda periudhës **30 ditë pune (e hanë – e shtunë)** , sipas kushteve të kontratës të përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës.
- 1.4 Kryesi i punimeve ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Porositësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.
- 1.5 Kryesi i punimeve do të penalizohet me shumën prej 0,10% të vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë të kryerjes së punëve të papërfunduara deri në një shumë prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontraktuar.

Neni 2 Çmimi

- 2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **35.256,15€ (tridhjetepesmijdyqindpesdhjetegjsthtë/15Euro)**.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen : në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Projektit dhe Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues.

2.4 Pagesa e fundit do të kryhet pasi Kontraktuesi të ketë përfunduar punimet dhe Komisioni i Pranimit Teknik të ketë lëshuar Raportin për pranimin teknik të punimeve të përfunduara, me Situacion të nënshkruar nga Menaxheri i Projektit dhe Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës se vendit
- (h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe¹ në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.



¹ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Saranda Cakaj
Pozita:	Drejtoreshë për Prokurim Publik
Nënshkrimi:	
Data:	24.10.2019
Vula:	



Për Kontraktuesin:

Emri:	Gentian Dëshishku
Pozita:	 Përfaqësues i Kontraktuesit: “ Dëshishku GB “sh.p.k. – Pristinë
Nënshkrimi:	
Data:	24.10.2019
Vula:	



PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.


Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë : Ligji në fuqi në Republikën e Kosovës.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : gjuhët zyrtare në vend.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është : 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës, në kohëzgjatje prej 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës e lëshuar nga një Bankë ose Kompani e sigurimeve e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 2 (ditë) ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është : konform planit dinamik të dorëzuar sipas afatit të përcaktuar paraprakisht në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : 3 (Tre) ditë pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë : sipas Planit Dinamik , por jo më gjatë se afat i përcaktuar paraprakisht në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë. - fillimi i punimeve: 3 (Tre) ditë pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0,10 % të çmimit përfundimtar të Kontratës, për ditë të vonuar. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Kontraktuesi – Kryesi i Punimeve dhe Menaxheri i Projektit - Organi Mbikëqyrës i Autoritetit Kontraktues do të mbajnë Librin e Punës dhe Librin

Titulli: Ndërtimi i kanalizimit Stanofc-Breznicë

		Ndërtimor, gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës, për të evidentuar gjitha përkrahjet e punimeve të ekzekutuara në terren, për të konfirmuar sasinë dhe cilësinë e materialeve të përdorura në objekt – vend punishte, gjithashtu për të evidentuar ecurinë e punimeve, pengesat eventuale, aktivitetet e ndërmarra për eliminimin e pengesave të shfaqura, kohëzgjatjen e kohës sa kanë zgjatur pengesat dhe në fund, pas përfundimit të punimeve, për të dhënë një Rekapitulim të ecurisë së punimeve përmes të dhënave në shifra dhe data.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit dhe Organi mbikëqyrës : do të emërohet me vendim të veçantë nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, pas nënshkrimit të kontratës. Do të jetë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe mbikëqyrjen e cilësisë, sasisë dhe përshtatshmërisë së punimeve në objekt, në pajtim me dispozitat e saktësuara si në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës dhe detyrat e përshkruara në vendimin mbi emërimin.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N / A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: N / A
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë : 30 (Njëzetepesë) ditë pune pas nënshkrimit të kontratës dhe fillimit të punimeve, konform Planit dinamik por jo më gjatë se Plani dinamik i përcaktuar në pikën II.3 të Njoftimit për Kontratë.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është : Periodha garantuese e defekteve është : 36 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm në shumë prej 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës, për defektet e paraqitura në objektet sipas Dokumentit – Polisa e sigurimit e lëshuar nga një bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovëpër kualitetin e punëve me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 37 muaj nga data e pranimit teknik.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është : përqindja e vlerësuar e punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.

Shënim: Te përshkrimi i gmitave duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
 Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, 18, e jo në formatin 0%-8%-apo 18%
 Nëse në kolonën G, duhet ta plotësoni me gminin për njësi me TVSH. Po ashtu gminin duhet ta shkruani me dy decimale pas presjes
 dhjetore
 Vërejtje: Gmimi për çdo pozicion duhet të përshfaqet: Elejën, furnizimin, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet shtetë e pozicionit
 në gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atastave të prodhuesve. Në gmin duhet të
 kalkulohet gjithashtu i terë materiali shpërndues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaritja e pozicioneve të bënë sipas gjendjes së
 rrethimit në terren


Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Një sia Mat ëse	Sasi	Gmimi i për njësi pa TVSH	Nor ma e TVS H-së në %	Çmi mi për njës i (me	Total i (Pa TVS H)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
1	PUNËT PËRGADITORE								
1,1	NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË FSHATIN STANOVC I EPERME-BREZHNICË- KOZARICË ME L=700m'								
	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në ndërtimin e kanalizimit . Në gmin të llogaritët kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes se makinave dhe staffit punues	m'	700,0		18,00	2,50	0,00	1 750,00	1 750,00
1,2	Inqizimi gjeodezik trases se terrenit verifikimi i gjendjes egzistuese puntimi i profilët gjatësorë, identifikimi i sakte i pusetave para fillimit të punimeve, llogaria per ter gjatesin e trases	m'	700,0		18,00	1,00	0,00	700,00	700,00
1,3	Hekja e materialeve mbi siperfaqën e tokës përfshihë eche demolimi i kubzave të betonit , preja e asfaltit dhe të gjitha të gjeturat në infrastrukturën nërëtoksore ,prejen e gypave të ujit , kanalizimit dhe për të gjitha këto të shëndrrohën në gjendjen e funksionale	m'	700,0		18,00	1,00	0,00	700,00	700,00




2 PUNËT TOKËSORE									
2.1	Prerja e asfaltit ne gjatësi L=35M, gërmimi dhe planifikimi rjedhes natyrore ne forme trapezi të pirockes sipas përshkrimit b=1.5-2.2m ; h=1.70-2.8m , llogaria per gjate tere gjatesise se pirockes-trases	m'	250,0	18,00	5,00	0,00	1 250,00	1 250,00	
2.2	Gërmimi i kanalit sipas projektit për kolektorët kryesor në dheun e kat. III-IV më makinë apo me dorë me thellësi sipas projektit (h=2,20-4,5m) dhe më gjërësi sipas normative dhe standardeve, Llog. në m3 , në gjatësi prej 700m' si vijon:								
2.2.1	Gërmimi me makineri 70%	m3	490,0	18,00	0,90	0,00	441,00	441,00	
2.2.2	Gërmimi me dorë 30%	m3	210,0	18,00	1,50	0,00	315,00	315,00	
2.3	Sigurimi i kanalit nga shembja e dheut. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normative për këtë lloj pune, në të dy anët e kanalit. Llog. në m1 të kanalit	m'	700,0	18,00	0,40	0,00	280,00	280,00	
2.4	Largimi devijimi i ujërave sipërfaqesore të pirockes dhe atyre nën tokësore me pompa adekuate gjatë hapjes së kanalit dhe instalimit të gypave (në llogari është marrë gjatësia e trasës e cila kalon nëpër pirockë). Llog në m1	m'	700,0	18,00	0,90	0,00	630,00	630,00	
2.5	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm. Llog. Në m1 të kanalit	m'	700,0	18,00	0,40	0,00	280,00	280,00	
2.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës se bute adekuate në fundin e kanalit, anash dhe mbi gyp. Rëra në fundin e kanalit vendoset me një trashësi min. t=10 cm, ndërsa mbi gyp min. t=10.0 cm. Llogaria në m3	m³	294,0	18,00	4,00	0,00	1 176,00	1 176,00	




2.7	Mbulimi i kanalit pas instalimit të gypit dhe mbeshjtelljes së tij me tërë, Mbulimi bëhet nga dheu i germuar dhe atë në shtresa t=30cm dhe me ngjeshje. Llog. m3	m ³	406,0							284,20	284,20
2,8	Ngarkimi dhe transporti i dheut të germuar (epërt) në depoti të gytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës në largësi deri në 5km.	m ³	294,0			18,00	0,80	0,00		235,20	235,20
3	PUNËT MONTUESE TE GYPAVE										
3,1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të BETONIT ME QAFË për kolektorët kryesor, para fillimit të punimeve të këtyre gypave duhet të sillët mostra dhe atëstet për keto lloj gypash, nw kwtw pozicionw tw pwrfshtihen edhe hidroizolimi i pwr qwdo										
3.1.1	betnit 400mm	m'	700,0			18,00	10,00	0,00		7 000,00	7 000,00
4	PUNËT E PUSETAVE										
4.1	Ngjeshja e fundit të pusetave me ngjeshes adëkuat, si dhe vendosja e zhavorit O-32mm me ngjeshje, Llogarria në copë	copë	61,0			18,00	4,00	0,00		244,00	244,00
4.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme në pusea me betonarme C- 20/25 d=20cm në logarin të merret edhe sasia e betonit për punimin e kinetave	m ³	42,7			18,00	55,00	0,00		2 348,50	2 348,50
4.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e armatures rrejtë Q335 në pllaken e poshtme të pusetës, Llog në m2	m ²	61,0			18,00	2,00	0,00		122,00	122,00
4.4	Furnizimi transporti dhe montimi i gypave (për pusea) prej betonit Ø1000mm gjatesia e ndryshueshme varësishte nga thellësia (elemente të parafabrikuara). Llogarria në m1	m'	91,5			18,00	33,00	0,00		3 019,50	3 019,50
4.5	Furnizimi transporti dhe montim i konuseve për pusea prej betonit Ø1000/600/550mm (elemente të parafabrikuara).	m'	61,0			18,00	25,00	0,00		1 525,00	1 525,00



4,6	Furnizimi, punimi dhe montimi i shkallëve prej armatures Ø20 në çdo 30cm dhe inkastimi i tyre në beton, armatura duhet te jete me lryje antikorrozive.	copë	64,0			18,00	3,00	0,00		192,00	192,00
4,7	Furnizimi, transporti montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize me peshë mbajtëse T = 25 ton. Në qimin të llogaritët kapaku, korniza e gizes dhe betoni C-25/30 i përforcuar me armaturë. Llog. në copë	copë	24,0			18,00	55,00	0,00		1 320,00	1 320,00
4,8	Furnizimi dhe punimi i kyqjeve individuale ne puseta, punet perfshin hapjen dhe mbylljen e kanalit me gjatësi l=10 m gypin PEHD Ø200, reren , largimin e dheut të tepert dhe depertimin ne pusetë	copë	45,0			18,00	45,00	0,00		2 025,00	2 025,00
4,9	Furnizimi me material asfalt beton 016 me trashësi t=8cm për shtrijën dhe ngjeshjen e sipërfaqes	m ²	80,0			18,00	15,00	0,00		1 200,00	1 200,00
5	PUNËT TJERA										
5,1	Tejkalimi (shpimi horizontal) i pengesave të ndryshme qe dalin për gjatë trasës, rruges se asfaltuar, nen hekurudha dhe pengesat tjera. Në qimin të llogaritët gypi mbrojtës i çelikut me diameter Ø500mm. Në llogari të mirren të gjitha aktivitet tjera përçjellëse. Llog. Në m1 të gypit-deperimit	m'	22,0			18,00	75,00	0,00		1 650,00	1 650,00
5,2	Testimi i rjetës së kanalizimit, me prani te organit mbikqyres. Llogaria në m1	m'	700,0			18,00	0,50	0,00		350,00	350,00
5,3	Furnizimi me material dhe shtruja , ngjeshja e zhavorit me trashësi t=45cm mbi sipërfaqwn e gypave t'w betoinë	m ²	120,0			18,00	7,00	0,00		840,00	840,00
5,4	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakaws sw poshtwme t'w lumit mbi gypat e betonit me M/B 25/30,metrashwsi t=15cm	m ³	45,0			18,00	60,00	0,00		2 700,00	2 700,00
5,5	Furnizimi me material dhe armimi i pllakaws C40/500 rjeta Ø8/15cm	kg	3 375,0			18,00	0,69	0,00		2 328,75	2 328,75



5.6	Pas përfundimit të punimeve të bëhet planifikimi i terrenit, dhe për të gjitha materialet të shtrenjta atëherë dhe kompletimi i dokumentacionit me projektin sipas egzekutimit	m'	700,0	18,00	0,50	0,00	350,00	350,00
TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH :						0,00	35 256,15	35 256,15

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	"DESHISHKU GB" SH.P.K
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Gentian Deshishk
NËNSHKRIMI:	
DATA:	30.09.19 / SH.P.K
VULA:	